

## DRITA SILIQI

## FIGURA E GRUAS NË DRAMAT E VITEVE TË FUNDIT

Figura e gruas u shfaq që herët në letërsinë e realizmit socialist, krahas problemeve të reja që u bënë objekt pasqyrimi për letërsinë e re e, që në veprat e para, u dukën ndryshime cilësore në trajtimin e saj, në krahasim me letërsinë realiste të viteve '30. Vetë jeta e shtronte me forcë problemin e emancipimit politik e shoqëror të gruas dhe letërsia në përgjithësi ju përgjegj kësaj kërkesë duke krijuar figura të bukura e të realizuara grashë.

Autorët përpiquen të krijojnë në vepra figura të plota grashë, që përtërijnë me një përmbajtje të re cilësitë tradicionale të trimërisë, besës, sakrificës, ndershmërisë; bëjnë përpjekje për të paraqitur evolucionin e saj shpirtëror, për të treguar si rritet personaliteti i saj, si ajo vetë bëhet e ndërgjegjshme për të drejtat e rolin e saj në shoqëri.

Nadireja e romanit «Çlirimtarët», duke u lidhur me luftën, e ndjen se një përmbysje e madhe po ndodh në jetën e saj e të gruas shqipëtare, se fitorja do të siellë jo vetëm lirinë, po do të zgjidhë ndryshe fatin dhe të ardhmen e saj dhe të gjithë të rejave në përgjithësi. Ndërsa Afërdita («Afërdita përsëri në fshat»), që e ka fituar ndërgjegjshmërinë e misionit të saj, me gjithë idealizimin që i bën autori rolit të saj, përfaqëson gruan luftëtare që me guxim ndeshet me çdo gjë të vjetër, e çon të renë në fshat.

Por, ndonëse veprat e këtyre viteve (vitet 50) dallohen për trajtimin e ri të problemit, vihen re të meta, një farë skematizmi, apo shpesh, kur konceptohet problemi dhe figura e gruas, vihet re ndonjë ndikim nga letërsia e paraçlirimit. Ka raste kur figura e gruas vihet në qendër të veprave për efekte melodramatike, përpjekjet e saj për çlirim thjeshtësohen, zgjidhen përmes një plani sentimental-melodramatik («Votra e huej»). Me figurën e Rinës F. Gjata dha bukur zgjimin e ngadaltë të ndërgjegjes së gruas, botën e saj të pasur shpirtërore, por përpjekjet e saj për çlirim mbetën të pjesshme dhe autori i mbështeti në një artifis, kurse Tana si figura e gruas pararojë është konceptuar në mënyrë skematike, vihet të veprojë në një rrësh të pajustificuar nga pikëpamja shoqërore, veprimet e saj nuk u përshtaten kërkesave dhe realitetit të kohës.

Në se u trajtua deri tani kështu figura e gruas e në se problemi pati një shtrirje të kufizuar, kjo duhet shpjeguar kryesisht me të metat e letërsisë sonë në rritje po deri në një farë mase edhe me vetë shkallën e emancipimit të gruas, e cila e çliruar politikisht, po merr pjesë aktivisht në jetën shoqërore, po në disa fusha, sidomos në ambjentin familjar, akoma nuk e ka fituar barazinë e plotë.

Ndryshimet e mëdha që ndodhën në jetën ekonomike, shoqërore,

kulturale të vendit, sidomos pas Kongresit V të Partisë, e ngritën luftën për emancipimin e gruas në një shkallë më të lartë, e bënë atë një problem të madh politik të gjithë shoqërisë. Tani dilnin detyra të reja për të realizuar në jetë atë barazi që gruaja fitoi me ligj; gruaja duhej të tërhiqej e gjitha në prodhimin shoqëror, që të çlirohesh nga skllavëria ekonomike; ajo duhet të merrte pjesë gjithnjë e më shumë në drejtimin e ndërmarrjeve shoqërore, ajo duhet të luftonte dhe të digjte me zjarr këdo «që merr nëpër këmbë liqjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave».

Kuptohet që problemi edhe në letërsi mori gjithashtu një shprehje të re, që ndryshon nga faza e parë (vitet 50) qoftë për shtrirjen, qoftë për thellimin e tij. Në vëmendjen e shkrimtarëve qendrojnë edhe probleme që është bërë zakon t'i quajmë «të vogla» — i xhelozisë, i dashurisë. . po edhe probleme «të mëdha» — i dëshirës për arësim, i krijimit të familjes socialiste me norma të reja morale, i luftës së gruas kundër paragjyqimeve, patriarkalizmit, i afirmimit të personalitetit të saj si punonjëse, drejtuese e prodhimit, si aktiviste shoqërore.

\*

Dramaturgjia e viteve të fundit ka meritën që e trajtoi me sukses problemin dhe figurën e gruas. Në dramën jepet formimi shpirtëror i heroinave, sidomos momenti më i rëndësishëm, momenti i kthesës, i çlirimit nga shtypja morale, i afirmimit të ideve të reja. Gruaja perceptohet si forcë aktive revolucionare me botëkuptim të përparuar klasor, me tipare të reja të moralit komunist, e zhveshur nga mbeturinat e së kaluarës.

Problematika e gruas u kap nga shumë kënde vështrimi, u tregua se si ajo me luftë e heroizëm e çau rrugën e saj («Cuca e maleve» L. Papa), u tregua forca e saj për të luftuar e mposhtur zakonet e prapambetura që e kanë poshtëruar dhe marrë nëpër këmbë personalitetin e saj («Fisheku në pajë» F. Kraja, «Shembja» I. Uruçi, «Drita» M. Luca, «Flakë në shtëpi» Z. Cikuli, «Lina e urta» A. Bino etj.), si dhe rritja e rolit dhe e figurës së gruas si drejtuese dhe si aktiviste shoqërore («Fisheku në pajë» F. Kraja, «Ngjarje në fabrikë» F. Paçrami).

Në Kongresin V shoku Enver, duke theksuar rëndësinë e madhe politike, ideologjike e shoqërore të problemit të gruas, vuri në dukje se «problemi i tërheqjes së saj të plotë në prodhim dhe në tërë jetën shoqërore e shtetërore është akoma shumë larg nga zgjidhja e duhur. Në këtë rrugë ekzistojnë një varg pengesash serioze, ka një rezistencë të madhe.»<sup>1</sup> Këtij aspekti, që shpreh vështirësitë që hasen për zgjidhjen përfundimtare të problemit a m'anë tjetër forcën e gruas për të mposhtur e për të dalë triumfues mbi zakonet e prapambetura, që e kanë marrë nëpër këmbë personalitetin e saj, i kushtohen një varg dramash të viteve të fundit. Më me mprehtësi këto çështje do të ndesheshin në ambjentin fshatar — në përgjithësi më fanatik për shkak të sundimit të kanunit, ku vetë gruaja fshatare—punonjëse duhet të marrë përsipër emancipimin e saj. Kurse në të vërtetë nuk ndodh kështu, peshën kryesore në dramën tona të fundit e mban figura e gruas intelektuale. Deri në një farë mase kjo është e kuptueshme, sepse pasqyron një fenomen të vërtetë jetësor (përparimin më të shpejtë të gruas në ambjente intelektuale), por a është i pranueshëm? Realiteti,

1) E. Hoxha, Raport i mbajtur në Kongresin V, nëntor 1966.

jeta na tregojnë se nuk përfaqëson gruaja intelektuale elementin më të përhapur në vendin tonë dhe se problemi i emancipimit të saj, tashmë i realizuar në disa vështrime (shoqëror, ekonomik, kultural) nuk mund të marrë, për vetë gjendjen e saj, ato proporcione, atë thellësi që merr për gruan fshatare e punëtore.

Ndodh që protagonistja vetëm e nis luftën me atributet e fshatares apo të punëtore, në ambjentet përkatëse dhe e zhvillon, e zgjidh konfliktin me gjuhën, logjikën e intelektualës. Për shembull në pjesën e dytë të dramës «Shembja», Bardha fshatare kthehet mësuese, intelektuale. Kur lufton me këtë veshje të re e cilësi të reja, ajo shmanget nga linja kryesore e konfliktit, i cili nis në fshat e në familje, por kapërcen jashtë vendit të veprimit e si pasojë kemi një zgjidhje të jashtme. Autori u tërhoq nga një ngjarje e veçantë e jetës, s'e shtriu dot fenomenin në gjërësinë e vet për t'i dhënë caqet e një fenomeni shoqëror, prandaj me të drejtë kritika vëren se, ashtu siç është paraqitur, Badha mbetet rast i veçantë.

Drita e dramës homonime që, siç thotë autorja, përfaqëson klasën punëtore, merr nga klasa e saj vetëm guximin për të vepruar vetë në jetë. Mbasi jeton në ambjentin punëtor, formohet shpirtërisht e mendërisht për t'u ndeshur me mendimet patriarkale të burrit, por, si zgjohet ndërgjegja e saj ne nuk e ndjejmë, ndërsa ajo ndeshet kur hyn në radhën e intelektualëve dhe me gjuhën e tyre.

Sidomos në një masë jo të kënaqshme është pasqyruar në dramaturgji emancipimi i gruas punëtore, e cila, e çliruar ekonomikisht, bën përpjekje për lartësimin e saj intelektual dhe për afirmimin e idealeve të saj si bartëse e moralit të ri, moralit socialist. Ndër përpjekjet e para është figura e Mirës («Ngjarje në fabrikë»), e punëtore revolucionare, që, e nisur vetëm nga interesat e klasës, pa patur asnjë shkak personal, shpall e para sulmin kundër atyre që pengojnë punën dhe përparimin e shoqërisë, kundër intrigës, burokracisë, foddullëkut, tipare këto që s'pajtohen me moralin proletar. Ndërsa në dramën «Mbas dy vjetësh» protagonistes, traktoriste, i duhet të luftojë jo vetëm kundër pretendimeve mesquine prej pronari të burrit, por edhe kundër ideologjisë prej fshatari mikroborgjez individualist që ai përfaqëson e që shprehet në rendjen e ethshme pas parasë, pas interesit personal, në dëm të interesit të përgjithshëm.

Gruaja, për të fituar të drejtat e saj si qenje shoqërore, lufton kundër paragjykimëve patriarkale, kundër ligjeve skllavëruese të kanunit që e sakatuan fizikisht, mendërisht e shpirtërisht.

Drama «Cuca e maleve» (L. Papa) shtron një kompleks të gjërë çështjesh duke filluar që nga përpjekjet e para për përhapjen e dijes dhe ngritjes arësimore të masave të gjëra të popullit, për çrrënjosjen e paragjykimëve mesjetare, deri tek lufta në planin ideologjik e politik në mes të klasave. Por kryesisht autorin e ka tërhequr heroizmi i gruas, përqëndruar në figurën e Cucës. Vendosja e ngjarjes historikisht në rrethanat e luftës së ashpër për asgjësimin e diversantëve dhe kriminelëve (1948-1949), marrja si bazë e subjektivitetit të një konflikti me dramatisëm të veçantë dhe argumentimi i gjithë atij kompleksi çështjesh që dalin në vepër (përhapja e arësimit, pjesëmarrja e gruas në jetën shoqërore, lufta kundër zakoneve e kanunit), i dha mundësi autorit të skalisë të qartë e të fuqishme figurën e së resë që lufton pa kompromis me gjithshka pengon përparimin, që është e palodhshme në punën e saj, që nuk trembet nga kërcënimet, që përpiqet të zbulojë shkaqet në thellësi me rrënjë, në mënyrë që t'i luftojë e t'i zhdukë.

Pikërisht ato vite shoku Enver thoshte: «Disa njerëz prapanikë përpigjen të pengojnë vajtjen e vajzës në shkollë. Qëllimi i tyre s'do shpëgjim, ... një akt i tillë formon një krim të rëndë kundër përparimit të popullit — ata që do të guxojnë të vazhdojnë këtë propagandë shpejt do të pendohen»<sup>2</sup> — Cuca përpigjet të depërtojë në mendimet e njerëzve e t'i bëjë për vete zemrat e tyre, jo me forcë, po me argumenta, sepse është e bindur për efektin e madh të fjalës: «Plumbi vret një fjala vret dhjetë, njëqind. Na duhet me vra fjalën e tyre, po *deshëm me fitue*». Ndonëse figura e Cucës, që është trajtuar me shumë dashuri nga autori, merr ndonjëherë tiparet e një heroine romantike dhe gjatë shtjellimit të dramës nuk ka shumë zhvillim, ajo të bind, ndonëse jep realisht përpjekjet e gruas për çlirimin e saj gradual e, në anën tjetër, metodat herë të hapura, herë të fshehura, filistine të përfaqësuesve të regresit për ta penguar atë. Drama «Cuca e maleve», ndonëse bën fjalë për ngjarje që kanë ndodhur njëzet vjet më parë, tingëllon dhe sot aktuale, si pasqyrë e heroizmit me të cilin çan përpara gruaja shqiptare.

Në themel të dramave «Shembja» I. Uruçi e «Fisheku në pajë» F. Kraja, qendron ndeshja e dy ideologjive të kundërta, ndonëse bartësit e tyre janë në pozita të njëjta. Autorët i lokalizojnë ngjarjet në Shqipërinë e Veriut e të Mesme, pikërisht atje ku mbeturinat e patriarkalizmit rëndojnë më me forcë në ndërgjegjen e njerëzve, ku koncepti patriarkal — «burrat janë lisa me degë» dhe «gratë — hunj që ngulen kudo» — gjen ndonjë shteg për t'u përligjë.

Rrjedhimisht, në art, atje ku kontradiktat janë më të mprehta, zhvillimi i konfliktit dramatik ka një bazë më të fortë. Kurse autorët e tyre nuk kanë zbuluar në thellësi kontradiktat e brendshme të personazheve dhe nuk kanë motivuar zgjidhjen e tyre. Që figurat e krijuara të grave të marrin në skenë jetë, të marrin një vlerë artistike dhe një kuptim shoqëror, ato duhet të justifikojnë qenjen e tyre. Heroina në dramë duhet të luftojë me vetëdijë për të fituar të drejtat e saj; lufta e saj nuk mund të jetë spontane, një fenomen i rastit, por një akt i kushtëzuar nga ambjenti shoqëror dhe rrethanat objektive. Vetëm kështu konflikti nuk merr rrugën e zgjidhjes me anë të kompromisit të heshtur, vetëm kështu fitorja e së resë, vdekja e ngadaltë e së vjetrës motivohet. Në dramat që përmendëm personazhet mbartin koncepte, po nuk ndeshen me kundërshtarët në terrenin ideologjik që të arrihet në ndryshimin e këtyre koncepteve, kjo ka shpënë në ngushtimin e konfliktit apo në dështimin e idesë qendrore të veprave.

Bardha, që flet shumë për luftë, nuk zhvillon veprimtari shoqërore (përkundrazi veprimet e saj shpesh duken naive, jo të matura, të pajustificueshme për detyrën që i ka caktuar vetes), ajo vetë nuk është në gjendje të luftojë, edhe kur ka fituar vetëdijen për luftën që duhet të bëjë, kërkon rrugën zyrtare për të zgjidhur pengesat; Sadriu, vëllai, që mbart koncepte patriarkale, tërhiqet befás dhe s'e kuptojmë se si ndërron qendrim kundrejt së motrës, të cilën pak më parë desh ta martonte me dhunë.

Ndërsa drama «Fisheku në pajë» vuan jo vetëm nga mosthëllimi i konfliktit, gjë që e çoi autorin në një zgjidhje artificiale, në një skenë me efekt, jashtë kontradiktës së jetës e të dramës, por dëshmon edhe për një trajtim ideor jo të drejtë të problemit: Gjeloshi dhe Dashi, siç na i jep autori, janë njerëzit tanë, por pikëpamjet e tyre dhe qëndrimi

<sup>2</sup> Nga raporti mbajtur në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të FDSH, 7 tetor 1946.

që mbajnë ndaj gruas janë të huaja për shoqërinë tonë. Me konceptet e tyre duhet të luftonte Zana. Kjo në dramë nuk ndodh; për më tepër fatet e luftës dhe të fitores rrezikohen nga një bast. Prandaj në "dri-dhemi për fatin e Gjelinës që mbahet me një pe, po ashtu nuk pajtohemi, siç bën Zana deputete dhe vetë autori me arësytet, që e bindin Gjeloshin dhe Dashin të pranojnë Gjelinën në sofër. Ato janë arësytet e malësorit patriarkal që nderon trimërinë dhe trimëreshën, kurse morali ynë nderon njerinë, gruan.

Probleme të tjera shqetësojnë autorët dhe heroinat e dramave të ambientuara në qytet, në rrethe punëtorësh dhe intelektualësh. Autorët përpigën të gjurmojnë më thellë në shpirtin e grave, të tregojnë përpëlitjet e fundit të ndjenjës së nënshtrimit, frikës ndaj «autoritetit» të burrit, të fshijnë dhe gjurmët e fundit të sentimentalizmit që ruhen për vetë pozitën e tyre, sepse, si shkruan shoku Enver, gruaja është shumë më e lidhur me familjen dhe, që të mos i prishë këto lidhje, bën sakrifica parimore në të drejtat dhe në personalitetin e saj<sup>3</sup>, autorët përpigën të provojnë me heroinat e tyre se ç'pasuri ndjenjash, se ç'altruizëm, se ç'logjikë e qëllime të kthjellta i karakterizojnë gratë tona.

Flutura, heroina e dramës «Flakë në shtëpi» përfaqëson intelektualen e re, me forcë të madhe shpirtërore, me pjekuri ideologjike, gjë që pasqyrohet në kuptimin e ri që ka ajo për jetën dhe profesionin e saj humanitar. Ajo nuk e kupton që në fillim dashurinë e rreme të mikut të saj, njeri me një barrë mbeturinash borgjeze, që shprehen në përpjekjet për të siguruar rehatinë personale. Nga ndeshja e mendimeve të kundërta të Fluturës dhe të Astritit zbulohen dhe karakteret e ndryshme e të kundërt të tyre, duke i njohur interesat e ndryshme të tyre, që qartësohen gradualisht nga autori, ne e mbështesim veprimin e Fluturës, që ndahet nga Astriti, ndonëse e pat zgjedhur vetë si shok jete.

Të afërta për nga konceptimi i figurës së gruas dhe problemet që shtrojnë janë dy dramat «Drita» (M. Luca) dhe «Lina e urta» (A. Bino), në të cilat roli i gruas kufizohet, sipas mendimeve regresive, në një shtojcë për jetën e burrit, një amvisë e mirë, lule për të zbukuruar shtëpinë.

Këtu ndeshja merr një karakter më të ngushtë, zhvillohet brenda mureve të shtëpisë. «Raporti midis burrit dhe gruas — shkruan Marks, — është raporti më i natyrshëm i qenieve njerëzore. Si pasojë, aty shihet se deri në ç'pikë sjellja e natyrshme e burrit është bërë njerëzore.<sup>4</sup>

Në raportet e natyrshme e të drejta që krijohen në familje tregohet se deri në ç'masë çmohen aftësitë e gruas dhe luftohet për afirmimin e personalitetit të saj. Megjithatë, në jetë, si dhe në dramat që përmëndëm, ka familje ku gruaja mbahet akoma në shtëpi si stoli, ku gruaja, me gjithë ligjet që e kanë çliruar, vazhdon të jetë skllave e shtëpisë dhe i harxhon forcat e saj në një punë egërsisht jo prodhuese, të ulët, trulllosëse, që të shkatërron nervat dhe mendjen (Lenin)<sup>5</sup>.

Lina «e urta» e dramës homonime, vajzë e re intelektuale, përpi-

3) E. Hoxha, Fjala e mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, 18 tetor 1969.

4) K. Marks, *Prona private dhe komunizmi*, Dorëshkrime ekonomike dhe filozofike, 1884.

5) V.I. Lenin, *Iniciativa e madhe*, 28 qershor 1919.

qet të dalë nga ajo atmosferë jo e shëndoshë që e mbyl pas martese. Atë e thërret ambjenti i punës, atë e prek ndjenja e sakrificës së punëtorëve të minierës, motive të fortë këto që ajo, e mbyllur në shtëpi, ta ndjejë veten jashtë jetës, jashtë kohës. Për të drejtën e punës, që të japë dhe ajo ndihmën e saj në shoqëri, lufton me Skënderin; lufta e saj merr dhe karakter të mprehtë, ndonëse ajo e don të shoqin (edhe ai e do në mënyrën e tij) sepse ajo dëshiron të fitojë *besimin* e tij, të drejtën e ligjshme për të qenë të barabartë në familje. Për zbulimin e zhvillimin e figurës së Linës, autorja procedon drejt; në marrëdhënje me njerëzit Lina kupton ç'vlera shpirtërore fshehin nën pamjen e ashpër ata minatorë, shoferë, vagonistë — njerëzit që respekton me shumë — si i thotë Skënderit, e të cilët nuk dëshuan kurrë në ndershmërinë, drejtësinë e sinqeritetin e saj. Po jeta i zbuloi Skënderit se janë pikërisht këta njerëzit, që dijnë të çmojnë më shumë vlerat e njeriut e t'i besojnë atij, siç ndodhi me Linën. Autorja është përpjekur të provojë se ku e gjen forcën dhe mbështetjen Lina «e urta» të shpërthejë e të kthehet në një Linë «kryengritëse» kundër mendimeve patriarkale që ka burri për rolin e gruas në familje.

Ndërsa ndryshe veprohet në dramën «Drita» — thelbin e veprës e përbën lufta që bën heroina për të fituar të drejtën e arësimit dhe të punës, që ja mohon i shoqi, një pseudointelektual — Dhe të gëzon fakti që këtu ndeshemi në një heroinë të tillë të guximshme, që do të luftojë jo vetëm me konceptet patriarkale të burrit, po dhe me shumë vese me të cilët e ka ngarkuar autorja (ai është egoist, gënjeshtar, jo shumë serioz etj.).

Po sa e formuar është Drita për këtë luftë?

Ajo, ndonse paraqitet mjaft e avancuar në mendimet e kërkesat e saj, ka pranuar të ngrejë familjen në baza jo të drejta, është martuar me një burrë që s'e njeh, dhe kur fillon ta njohë pëson çgënime të mëdha. Prandaj alternativa që drama shtron në fund s'ka ku mbahet: ata jetojnë në një kulm, po familje s'kanë. Gjithashtu autorja e zhvillon heroinën jashtë dramës; ne nuk shohim si i realizon të drejtat për të cilat duhet të luftonte ajo. Për pasojë lexonjësi mbetet me përshtypjen se drama mbyllet pikërisht atëhere kur fillon konflikti, sepse ai zgjidhet në mënyrë deklarative.

\*

Gruaja mund të kthehet në një forcë të madhe, luftëtare aktive për ndërtimin e shoqërisë socialiste, nëqoftëse ajo është e ndërgjegjshme dhe politikisht e zhvilluar. Jeta provoi se ç'energji u çliruan me çlirimin e gruas, me çfarë ndërgjegje e pasion merr pjesë ajo në punë prodhuese, me ç'ndjenjë përgjegjësie jep kontributin e saj edhe në drejtimin e ekonomisë. I ri në dramaturgjinë tonë është trajtimi i figurës së gruas si aktiviste shoqërore, që e gjejmë në figurat e Zanës («Fisheku në pajë» F. Kraja) dhe Landës («Ngjarje në fabrikë» F. Paçrami).

Zana dhe Gjelina, kanë qenë shoqe të ngushta, të lidhura nga gëzimet dhe dëshirat e periudhës. Rrethanat jetësore, që përbëjnë kushtet objektive e subjektive, i ndanë rrugët e tyre dhe i dhanë drejtime të ndryshme në jetë. Në qytet, në gjirin e klasës punëtore Zana mësoi të punojë e të drejtojë, ajo u bë komuniste dhe aktiviste e shquar shoqërore; në punë ajo i tregoi jo vetëm aftësitë e saj, por edhe hovet e vrullshme shpirtërore. Zana është formuar në luftë me jetën, forca e

saj qëndron në lidhjet shpirtërore që ka me popullin, ideologjia e saj është ideologjia e Partisë, prandaj fitorja e saj mbi kanunin s'është një fitore personale, po është fitorja e së resë mbi të vjetrën. Ndërsa Gjelina, me një zgjuarësi aq të natyrshme e ndjenja aq të pastra, bëhet pre e zakoneve, e kanunit dhe humbet bashkë me të drejtën që të nderohet si *njeri* dhe të drejtën për të gëzuar në jetë. Takimi i tyre në dramë ndihmon të veprojnë reciprokisht: Zana duket sikur rritet më shumë shpirtërisht kur, nëpërmjet dramës së shoqes së rinisë, sheh vuajtjet e vajzave malësore; Gjelina gjen te Zana mbështetjen nga do të nisi luftën kundër patriarkalizmit.

Landa është intelektualja e ardhur rishtaz si drejtuese në ndërmarrje, në ambjentin e klasës punëtore. Problemi që ngre në dramë autori me anë të kësaj figure është i rëndësishëm: gruaja mund të ngrihet në përgjegjësi duke u ndeshur me mendimet konservatore, që përçmojnë ose nënvleftësojnë aftësitë e saj; në luftë dhe me vetveten për të fituar besimin, sigurinë në aftësitë e veta — Heroina, ndryshe nga ç'gjykon burokrati, është administratore e profesioniste e aftë, është drejtuese që di të lidhet me punëtorët, po, në dramë, ka më shumë një rol pasiv. Ndoshta nuk merr pjesë gjallërisht në demaskimin e J. Drizës, nga që dëshëron që punëtorët të thonë vetë fjalën e tyre. Sidoqoftë ka raste që të le përshtypjen sikur ajo përpiket të mbrojë veten nga sulmet e Jasharit.

\*

Është meritë e dramaturgjisë së viteve të fundit që e trajtoi në gjerësi dhe në thellësi problemin e gruas. E reja në pohimin e figurës së gruas në këtë gjini mund të vështrohet në faktin që problemi tani ka një tingull të gjerë shoqëror, me një tendenciozitet të qartë politik, konceptohet përgjithësisht drejt, zhvillimi i tij çon në zgjidhje jo me karakter individual (si Nora e Ibsenit), por në pohimin e idealeve të reja të shoqërisë sonë. Gjithashtu është arritur një trajtim më i thelluar ideo-artistik i temës, një paraqitje më realiste e konflikteve, një perceptim më konkret i figurave të grave dhe rrethanave jetësore të vërteta.

Por, me gjithë sukseset e shënuara, akoma nuk ka mundur t'u shpëtojë disa të metave. Mungon një trajtim i thelluar i figurës së gruas, bota e saj shpirtërore nuk zërthehet në të gjithë kompleksitetin e ndjenjave, nuk shpalosen të gjitha fletët e shpirtit të saj. Shpesh formimi i brendshëm i gruas jepet cekët (Bardha, Drita). Ndothë që kontradiktat emërohen, po nuk zbulohen, që më vonë edhe të ndeshen, argumentat që përdoren shpesh tingëllojnë anakronike. Duke mos u thelluar kontradiktat, momenti i shpërthimit të tyre herë bëhet artificial («Shembja» I. Uruçi, «Drita» M. Luca), herë merr zgjidhje të pabesueshme, mekanike, jo të drejta edhe ideologjikisht («Fisheku në pajë» F. Kraja).

Mbetet si detyrë e dramës dhe letërsisë sonë në përgjithësi të krijojë figurën e plotë të paharruar të gruas me botë të pasur shpirtërore, që të ketë forcë të madhe edukuese.

Jeta u sugjeron shkrimtarëve tanë aspekte nga më të ndryshmet të këtij problemi, që do ta zgjëronin diapazonin e temave të rrahura deri tani. Gjithë populli pret vepra të reja, ku roli e figura e gruas të jepen me një frymëzim më të madh, në perspektivën e saj të shkëlqyer.

